



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Kolaudim dhe rimbushje fikse zjarri”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24951230-6 -  
Mbushje për bombola gazi zjarrfikës

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,397,880 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

### **Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:**

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

### **OSE**

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje për mirëmbajtjen dhe tregtimin e pajisjeve dhe lëndëve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit, të lëshuar nga institucionet përkatëse.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të licencuar për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e vet për të paktën tre muajt e fundit, minimumi 1(një) punonjës ekspert zjarrfikës të çertifikuar nga institucioni përkatës i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për këtë të paraqitet:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Certifikata përkatëse për ushtrimin e profesionit.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat punonjesi i siperpermendur duhet te figuroje.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e specialistit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë staf të specializuar për kryerjen e shërbimit dhe ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencë për ushtrimin e aktivitetit lëshuar nga QKB, kodi 1.2A “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbojtjes civile.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e kryejnë veprimtarinë e vet në përputhje me objektin e prokurimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë sipas të cilës merr përsipër transportin e fikseve nga vendi origjinës kryerjen e procesit të kolaudimit rimbushjes dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë mjete transporti për kryerjen e

shërbimit me sukses dhe ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

### **Njesia e prokurimit:**